

V E N D I M
Nr.297, datë 30.6.1994

PËR RREGULLIMIN E KOHËS SË PUNËS DHE PUSHIMIT NË INSTITUCIONET SHËNDETËSORE

Në zbatim të ligjit nr.7724, datë 22.6.1993 "Për rregullimin e kohës së punës dhe të pushimit", me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Koha javore e punës është 40 orë. Rregullimi i kohës së punës në institucionet shëndetësore bëhet me udhëzim të Ministrisë së Shëndetësisë, duke u bazuar në specifikat e institucioneve shëndetësore.

2. Niveli i pagës mujore të çdo punëmarrësi nuk ndryshon. Për efekt të llogaritjes së pagës mujore, muaji merret mesatarisht 21 ditë efektive pune.

3. Punëmarrësve për punën e tyre në ndërresën e dytë, u paguhet një shtesë në pagë 20 për qind të pagës në ndërresën e parë, kurse për punën e tyre në ndërresën e tretë u paguhet një shtesë në pagë 50 për qind të pagës në ndërresën e parë.

4. Për vitin 1994, duke filluar nga data 1 korrik 1994, punëmarrësit do t'i paguhet vetëm shtesa për ndërresën e tretë në masën 20 për qind të pagës në ndërresën e parë.

5. Punëmarrësi që punon ditët e diela ose të festave zyrtare, për orët e punuara kompensohet me ditë pushimi gjatë javës.

6. Pushimi vjetor i pagueshëm për punëmarrësit në sektorin e shëndetësisë është 12 deri në 21 ditë pune.

Diferenca për efekt të moshës, vjetërsisë së përgjithshme në punë, llojit të punës dhe llojit të punës sipas funksioneve bëhet duke shtuar ditë pushimi mbi pushimin nominal që është 12 ditë sipas ndarjeve të mëposhtme:

a) Moshë (në vite)	Ditë që shtohen
Deri në 30	0 ditë
Mbi 30-40	1 ditë
Mbi 40-50	2 ditë
Mbi 50	3 ditë

b) Vjetërsia në punë (në vite)	Ditë që shtohen
Deri në 5	0 ditë
Mbi 5-15	1 ditë
Mbi 15-25	2 ditë
Mbi 25	3 ditë

c) Lloji i punës (në grupe)	Ditë që shtohen
Grupi IV	0 ditë
" III	1 ditë
" II	2 ditë

- Në grupin IV përfshihen personeli i mesëm shëndetësor, nëpunësit e thjeshtë dhe punëtorët.
- Në grupin III përfshihen specialistët me arsim të lartë, shefat e reparteve, kryetarët e degëve dhe punëmarrësit e tjerë që kanë të njëjtën shkallë me ta në pagë.

- Në grupin II përfshihen zëvendësudrejtorët, drejtorët dhe punëmarrësit që kanë të njëjtën shkallë me ta në pagë.

7. Në varësi nga lloji i punës (ndarë në grupe sipas funksioneve në organikë) punëmarrësit marrin pushim plotësues si më poshtë:

Lloji i punës (në grupe)	Ditë pushimi plotësues
Grupi IV	0 ditë
Grupi III	2 ditë
Grupi II	5 ditë

- Pushimi vjetor për punëmarrësit që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç, është 18 ditë.
- 8. Punëmarrësit i jepet pushim i jashtëzakonshëm i papagueshëm deri në 3 muaj në vit, kur ky nuk sjell dëm për punën, në këto raste:
 - a) Vdekje dhe martesë në pjesëtarët e familjes.
 - b) Përkujdesje për anëtarët e familjes.
 - c) Fatkeqësi në familje.
- Pushimi i jashtëzakonshëm jepet me urdhër të titullarit të institucionit.
- 9. Në shëndetësi lejohet puna e grave në ndërresën e tretë.
- 10. Efekti financiar për vitin 1994 prej 9 milionë lekësh përballohet nga buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit.
- 11. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit për të nxjerrë udhëzimet përkatëse.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, me përjashtim të pikës 3 që hyn në fuqi më 1.1.1995.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi